

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Bashkia Skrapar me fondet e veta do te bleje nje sasi prej 715 m3 dru zjarri. Ne momentin e dorezimit nga subjekti i kontrolluar drute e zjarrit duhet te jene te stivuara ne stive me lartesi 1m dhe pastaj behet matja dhe marrja ne dorezim e tyre.

Drute e zjarrit do te transportohen dhe dorezohen nga subjekti kontraktuar ne destinacionet e percaktuara nga Bashkia.

### **Kerkesat teknike:**

1. Dru zjarri : Lloji ah ose dushku
2. Diametri : Mbi 5cm ndare si me poshte:
  - a. Diameter 5-15cm, te rrumbullaket, te pacara, jo me shume se 10% e sasise
  - b. Diameter 15cm e larte 90% e sasise ose e gjithe sasia e kontraktuar. Drute e zjarrit te jene te cara ne funksion te diametrit me qellim qe te jene te manovrueshme gjate ngarkim-shkarkimit dhe prerjes se tyre per ne sobe.
3. Drute e zjarrit mund te jene te njoma apo te thata . Nuk pranohen dru te kalbura e mbeturina dhe nese rezultojne do te zbriten nga volume total.
4. Kontraktori ka per detyre te transportoje, shkarkoje e stivose drute sipas orientimit te perfaqesuesit te Bashkise , te mase dhe te shkurtoje me mjetet punetoret e shpenzimet e veta.
5. Matja e sasive se furnizimit do te behet me kubike me permasa 1mx1mx075 m .
6. Ne cmim eshte perfshire edhe transporti, shkarkimi dhe stivosja e druve ne vendin e caktuar paraprakisht nga Bashkia (ne objektet shkollore , ne godinat NJA apo depot e druve) sipas planit te shperndarjes te dhene nga Bashkia Skrapar .

### **PERGATITI:**

**Ing. Nebi HASA**